

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXV, nr. 8050  
E premte, 9 maj 2025  
Çmimi 0.50 €

## Vatikani, si Kuvendi i Kosovës!

FAQE 6

BEHXHET SH. SHALA - BAJGORA



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## HASANI: KUSHTETUTA NUK THOTË QË KRYEPARLAMENTARI DUHET TË ZGJIDHET ME VOTË TË FSHEHTË



Ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani, ka bërë me dije se mënyra e votimit për zgjedhjen e kryeparlamentarit nuk mund të ndryshohet në

proces. Hasani ka theksuar se Kushtetuta e Kosovës nuk parasheh që kryetari i Kuvendit mund të zgjidhet me votë të fshehtë. Hasani, i cili e ka shkruar

Aktgjykimin e Kushtetueses të vitit 2014, ka treguar se ky dokument askund nuk thotë që kryeparlamentari duhet të gjedhet me votë të fshehtë

### AKTUALE



KADETËT E FSK-së, PJESË E GARËS NDËRKOMBËTARE NË WEST POINT TË AMERIKËS F. 6

"PRISHTINA PARKING", GJYKATA RRËZON GJOBAT DHE BLOKIMET E VETURAVE F. 6

### EKONOMI



RRITEN TË HYRAT E QEVERISË NË VITIN 2024 KRAHASUAR ME VITIN 2023 F. 8

RRITEN ÇMIMET E MALLRAVE NË BUJQËSI F. 8

### SPORT



FFK-JA SHPËRNDAN LICENCAT C PËR TRAJNERE F. 10

LDK-ja DORËZON KALLËZIM PENAL NDAJ KURTIT DHE MINISTRAVE NË DETYRË F. 3



PSE S'KA ZHURMË TË PUNIMEVE NË SHESHIN E PRISHTINËS, POR SHERR MES INSTITUCIONEVE? F. 3



**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mok: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE MITROVICË  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030-500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## BDI thellon bashkëpunimin me NDI-në amerikane

**SHKUP, 8 MAJ** - Bashkimi Demokratik për Integrim nënshkroi një Memorandum Bashkëpunimi me Institutin Nacional Demokratik (NDI), duke forcuar partneritetin tonë me këtë institut të njohur ndërkombëtarisht për përkrahjen e proceseve demokratike dhe forcimin e institucioneve anembanë botës.

Ky bashkëpunim synon ta

thellojë shkëmbimin e praktikave të mira në fushat e transparencës, llogaridhënies, etikës dhe integritetit të partive politike. Po ashtu, ai përfshin mbështetjen për barazi gjinore, përfshirjen e të rinjve dhe rritjen e rrjetëzimit me partitë simotra ndërkombëtare.

Memorandumi, gjithashtu, përfshin angazhimin për avancimin e proceseve zgjedhore të lira dhe të drejta, si

dhe respektimin e standardeve demokratike dhe kodit të sjelljes të administruar nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve.

BDI do të kontribuojë në zbatimin e aktiviteteve të përbashkëta me NDI-në, përfshirë ndarjen e resurseve, mbështetjen logjistike dhe pjesëmarrjen aktive në çdo hap të këtij bashkëpunimi të rëndësishëm.



## Bill Gates do t'i dhurojë 200 miliardë dollarë për më të varfrit deri në vitin 2045

**NJU-JORK, 8 MAJ** - Bill Gates premtoi të enjten se do ta dhurojë pothuajse të gjithë pasurinë e tij personale gjatë dy dekadave të ardhshme. Siç tha, rreth 200 miliardë dollarë do të shkojnë për më të varfrit e botës përmes fondacionit të tij, në një kohë kur qeveritë në mbarë botën po shkurtojnë ndihmën ndërkombëtare.

Filantropi 69-vjeçar dhe bashkëthemeluesi i Microsoft-it tha se po përshejton planet për ta ndarë pasurinë dhe për ta mbyllur Fondacionin Gates më 31 dhjetor 2045. "Njerëzit do të thonë shumë gjëra për mua kur të vdes, por jam i vendosur që 'vdiq i pasur' të mos jetë një prej tyre", shkroi Gates në një postim në faqen e tij të internetit. "Ka shumë probleme urgjente që duhen zgjidhur për të mbajtur burime që mund t'i ndihmojnë njerëzit", theksoi ai.

Në një kritikë të tërthortë ndaj presidentit amerikan Donald Trump, për shkurtime në ndihmën e jashtme të Shteteve të Bashkuara - donatori më i madh në botë - Gates tha se dëshiron të ndihmojë në parandalimin e vdekjeve të foshnjave, fëmijëve dhe nënave nga shkaqe të shmangshme, të luftojë sëmundje si poliomieliiti, malaria dhe fruthi dhe ta reduktojë varfërinë. "Është e paqartë nëse vendet më të pasura të botës do të vazhdojnë



t'i mbrojnë më të varfrit", shtoi ai, duke përmendur shkurtime e ndihmave edhe nga Mbretëria e Bashkuar dhe Franca.

Gates theksoi se, pavarësisht prej buxhetit të madh të fondacionit, përparimi nuk do të ishte i mundur pa mbështetjen e qeverive. Ai vlerësoi reagimin e disa vendeve afrikane ndaj shkurtimeve të ndihmave, të cilat kanë rialokuar buxhetet e tyre, por

theksoi se, për shembull, poliomieliiti nuk mund të çrrënjohet pa financimin nga ShBA-ja.

Gates e bëri njoftimin me rastin e 25-vjetorit të themelimit të fondacionit, të cilin e krijoi në vitin 2000 me ish-bashkëshorten e tij, Melinda French Gates, dhe më vonë iu bashkua investitori Warren Buffett. "Kam ardhur shumë larg që nga koha kur isha një djalë që

nisja një kompani softueri me shokun tim nga shkolla e mesme", tha ai.

Që nga krijimi i fondacionit ka dhuruar 100 miliardë dollarë, duke ndihmuar në shpëtimin e miliona jetëve dhe mbështetur iniciativë si grupi për vaksinim Gavi dhe Fondi Global për Luftimin e HIV/AIDS, Tuberkulozit dhe Malariaes. Sipas Gates, fondacioni do të mbyllet pasi të ketë shpenzuar

rreth 99 % të pasurisë së tij personale.

Fillimisht, themeluesit kishin parashikuar që fondacioni të vazhdonte për disa dekada pas vdekjes së tyre. Gates, pasuria e të cilit vlerësohet rreth 108 miliardë dollarë, pret që fondacioni të shpenzojë rreth 200 miliardë dollarë deri në vitin 2045, me shifrën përfundimtare që do të varet nga tregjet dhe inflacioni. Fondacioni tashmë është një nga aktorët më të mëdhenj në fushën e shëndetësisë globale, me një buxhet vjetor që pritet të arrijë në 9 miliardë dollarë deri në vitin 2026. Ai ka përballuar kritika për fuqinë dhe ndikimin e tepërt në këtë fushë, pa llogaridhënie të mjaftueshme - përfshirë edhe në Organizatën Botërore të Shëndetësisë.

Gates ka qenë, gjithashtu, objekt i teorive të konspiracionit, veçanërisht gjatë pandemisë së Covid-19. Ai ka zhvilluar disa biseda me presidentin Trump muajt e fundit lidhur me rëndësinë e vazhimit të investimeve në shëndetin global. "Shpresoj që edhe njerëzit e tjerë të pasur të mendojnë se sa shumë mund ta përshejtojnë përparimin për më të varfrit e botës, nëse rrisin ritmin dhe shkallën e dhurimeve të tyre, sepse është një mënyrë jashtëzakonisht e fuqishme për t'i dhënë diçka pas shoqërisë", shkroi Gates.

## Turqia bllokoi llogarinë në X të kryetarit të burgosur të Stambollit, Imamoglu

**ANKARA, 8 MAJ** - Qasja në llogarinë e kryebashkiakut të burgosur të Stambollit, Ekrem Imamoglu, në rrjetin social X në Turqi, është bllokuar pas një kërkesë ligjore, sipas një njoftimi në llogarinë e tij në këtë platformë, të enjten.

Policia e arrestoi Imamoglun, i cili është rivali kryesor i presidentit Tayyip Erdogan - më 19 mars, duke nxitur protestat më të mëdha në Turqi në dekadën e fundit. Ai u

burgos katër ditë më vonë në pritje të gjyqimit për akuza për korrupsion të cilat ai i mohon. Partitë opozitare e kanë quajtur arrestimin e tij të politizuar dhe antidemokratik. Llogaria e Imamoglut në X i ka gati 10 milionë ndjekës.

Avokati i njohur turk Gonenc Gurkaynak tha në X se, me kërkesë të platformës X, do ta bëjë një ankesë ndaj vendimit gjyqësor për bllokimin e qasjes në llogarinë e kryebashkiakut.

Ende nuk janë bërë të ditura hollësitë e vendimit për bllokimin e qasjes në llogarinë e tij në Turqi.

Ndërkohë, sondazhet tregojnë se mbështetja popullore për Imamoglun është rritur edhe më shumë që nga arrestimi i tij, duke forcuar bindjen se ai do të jetë rivali kryesor i Erdoganit në zgjedhjet e ardhshme presidenciale të cilat janë planifikuar për vitin 2028.



## Formimi i institucioneve të reja, temë diskutimi mes Osmanit dhe Prattipatit

Prishtinë, 8 maj - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të enjten në takim të Ngarkuarën me Punë të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në

Kosovë, Anu Prattipati. Në takim u diskutuan zhvillimet e fundit në vend, situata e sigurisë në Kosovë dhe në rajon, si dhe ecuria e formimit të institucioneve të

reja. Gjithashtu, gjatë takimit u trajtuan edhe një sërë çështjesh të tjera që lidhen me marrëdhëniet bilaterale ndërmjet Kosovës dhe Shteteve

të Bashkuara të Amerikës, me theks të veçantë në fushat me interes të përbashkët, në veçanti fushën e mbrojtjes, si dhe mundësitë për thellimin e bashkëpunimit në të ardhmen.



## LDK-ja DORËZON KALLËZIM PENAL NDAJ KURTIT DHE MINISTRAVE NË DETYRË

EPOKA ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 8 MAJ - Deputetë të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) kanë dorëzuar zyrtarisht kallëzime penale në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës ndaj ish-kryeministrit Albin Kurti dhe të gjithë ish-ministrave të qeverisë së kaluar të cilët janë zgjedhur deputetë për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar, në kundërshtim me Ligjin për Qeverinë, i shkruar dhe miratuar nga vetë ky pushtet, si dhe Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

Sipas komunikatës së LDK-së, pas certifikimit të tyre si deputetë më 27 mars, këta zyrtarë kanë vazhduar të ushtrojnë funksione ekzekutive, duke marrë vendime të një natyre që ndalohet qartësisht nga neni

26 i Ligjit për Qeverinë, i cili kërkon dorëheqje të detyrueshme nga pozita qeveritare në rast të certifikimit si deputet. "Duke mos u larguar nga funksionet ekzekutive dhe duke vazhduar të përdorin burimet institucionale të shtetit, të dyshuarit kanë vepruar në kundërshtim me ligjin dhe kanë prodhuar pasojë konkrete institucionale, financiare dhe juridike. Këto veprime përbëjnë shkelje të rëndë të parimeve të shtetit të së drejtës dhe konsumojnë elementet e veprës penale të nenit 414 të Kodit Penal të Kosovës - keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar. Deputetët e LDK-së kërkojnë nga Prokuroria që të nisë hetime penale ndaj të gjithë të dyshuarve, të shqyrtojë të gjitha vendimet e marra nga Qeveria pas datës së certifikimit si dhe të



ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar përgjegjësi penale dhe politike", është theksuar në komunikatën e LDK-së. Më tej thuhet se kjo është një

thirrje e qartë për përgjegjësi ligjore dhe integritet institucional. "Për LDK-në askush, pavarësisht funksionit, nuk mund të vendoset mbi ligjin.

Republika e Kosovës duhet të funksionojë mbi themelet e barazisë para ligjit dhe ndarjes së pushteteve", është thënë në komunikatën e kësaj partie.

## EURODEPUTETI HOLANDEZ, I ASHPËR NDAJ BE-së: HIQINI PENGESAT, PRANOJENI APLIKIMIN E KOSOVËS PËR ANËTARËSIM



PRISHTINË, 8 MAJ - Eurodeputeti holandez Thijs Reuten ka bërë thirrje të fuqishme që Këshilli i Bashkimit Evropian t'i heqë pengesat dhe ta pranojë aplikimin e Kosovës për anëtarësim në BE. Në një fjalim të mbajtur në Parlamentin Evropian, Reuten theksoi se Kosova është partnere që ndan vlerat dhe perspektivën gjeopolitike të BE-së, dhe se bllokimi i aplikimit të saj për anëtarësim është i papranueshëm. "Kosova është partnerja jonë,

ndan vlerat tona dhe ka të njëjtin orientim gjeopolitik. Megjithatë, Këshilli i BE-së vazhdon ta bllokojë pranimin e thjeshtë të kërkesës për anëtarësim të këtij partneri. A kështu trajtohet një partner?" u shpreh Reuten, duke kritikuar qëndrimin e Këshillit. Ai i bëri thirrje BE-së t'i heqë masat kufizuese, t'i normalizojë marrëdhëniet mes të gjitha vendeve anëtare dhe Kosovës, si dhe ta njohë zyrtarisht shtetësinë e saj.

Reuten propozoi, gjithashtu, që edhe pa miratimin e Këshillit, Komisioni Evropian mund ta nisë përgatitjen e opinionit për aplikimin e Kosovës, si një hap drejt integritit të mëtejshëm. Kosova ka dorëzuar zyrtarisht aplikimin për anëtarësim në BE më 15 dhjetor 2022, por procesi mbetet i bllokuar për shkak të mosnjohjes së pavarësisë së saj nga Serbia dhe pesë vende anëtare të BE-së: Qipro, Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja.

## Osmani pranoi letrat kredenciale nga ambasadori i ri i Italisë

PRISHTINË, 8 MAJ - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka pranuar të enjten letrat kredenciale nga ambasadori i ri i Italisë, Maurizio Antonini. Presidentja Osmani i uroi ambasadorit Antonini mirëseardhje dhe suksese në misionin diplomatik në

Kosovë, duke theksuar marrëdhëniet e shkëlqyera ndërmjet dy shteteve dhe mirënjohjen e thellë të popullit të Kosovës për mbështetjen e vazhdueshme të Italisë në të gjitha fazat kyçe të shtetndërtimit dhe forcimit të pozitës së Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Në takim u theksua rëndësia e thellimit të mëtejshëm të bashkëpunimit dypalësh në fusha të ndryshme si dhe bashkëpunimi në kuadër të organizatave ndërkombëtare. Po ashtu, në takim u nënvizua rëndësia jetike e ecjes përpara në procesin e integritit euroatlantik të shtetit tonë.





# HASANI: KUSHTETUTA NUK THOTË QË KRYEPARLAMENTARI DUHET TË ZGJIDHET ME VOTË TË FSHEHTË

Ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani, ka bërë me dije se mënyra e votimit për zgjedhjen e kryeparlamentarit nuk mund të ndryshohet në proces. Hasani ka theksuar se Kushtetuta e Kosovës nuk parasheh që kryetari i Kuvendit mund të zgjidhet me votë të fshehtë. Hasani, i cili e ka shkruar Aktgjykimin e Kushtetueses të vitit 2014, ka treguar se ky dokument askund nuk thotë që kryeparlamentari duhet të zgjidhet me votë të fshehtë

**EPOKA  
ERE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 8 MAJ** - Kuvendi i Kosovës sërisht do të mbledhet sot (e premte) në orën 10:00, në përpjekjen e 13-të për ta konstituuar Kuvendin e Kosovës. Deputetët dështuan edhe në përpjekjen e 12 për ta konstituuar Kuvendin pas zgjedhjeve të 9 shkurtit. Procesi ka ngecur prej javësh pasi partia fituese, LV, nuk po arrin t'i sigurojë votat e nevojshme për kandidaten e saj për kryetare të Kuvendit, Albulena Haxhiu. Ajo shihet nga disa parti parlamentare si "figurë përçarëse", por LV-ja ngul këmbë se ajo është kandidatë meritore. Seanca dështoi për herë të 12

sepse nuk u votua një komision për votim të fshehtë për kryeparlamentar. Pro këtij komisioni votuan 56 deputetë, 1 kundër dhe nuk pati asnjë abstenim. "Seanca ndërpritet. Shihemi më 9 maj në orën 10:00", pati theksuar kryesuesi i seancës, deputeti Avni Dehari.

Ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani, ka bërë me dije se mënyra e votimit për zgjedhjen e kryeparlamentarit nuk mund të ndryshohet në proces.

Në një intervistë për "Euro News Albania", ai ka bërë me dije se Kushtetuta e Kosovës nuk parasheh që kryetari i Kuvendit mund të zgjidhet me votë të fshehtë.

Hasani, i cili e ka shkruar

Aktgjykimin e Kushtetueses të vitit 2014, ka treguar se as ky dokument askund nuk thotë që kryeparlamentari duhet të zgjidhet me votë të fshehtë. "Kur flitet për mënyrën e votimit në Kuvend, Gjykata Kushtetuese ka treguar se cilat janë mënyrat e votimit sipas rregullores atëherë dhe kësaj sot. Pra, nuk ka thanë që kështu me votë të fshehtë duhet bërë zgjedhja e kryetarit, sepse nuk ka mundur ta thotë, sepse një gjë e tillë përcaktohet me Kushtetutë, me ligj dhe me Rregullore të Kuvendit. Një gjë e tillë nuk e thotë Kushtetuta e Kosovës, e thotë për zgjedhje të presidentit. Ka mundur ta thotë siç e thonë disa kushtetuta evropiane, që thonë bëhet me votim të fshehtë, por nuk e ka thënë", ka treguar Hasani, duke shtuar se votimi i fshehtë ka mundur të caktohet vetëm në takimin e ish-kryetarit të Kuvendit, Glauk Konjufca, me përfaqësuesit e partive që kanë fituar ulëse në kuvend. "Ajo ka mundur të vendosej eventualisht më 8 prill kur është caktuar agenda për mbledhjen konstituive. Atëherë forcat politike kanë mundur të thonë se votimi do të jetë i fshehtë, por tani nuk mund të ndërrohet ajo. Kjo është tërësisht kaotike, tërësisht jokushtetuese dhe

tërësisht kundër sundimit parlamentar të ligjit", ka thënë Hasani.

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), si organizatë e shoqërisë civile që monitoron nga afër punën e Kuvendit dhe promovon transparencën, llogaridhënien dhe standardet demokratike në vendimmarrje, shpreh shqetësim të thellë lidhur me mënyrën e zhvillimit të votimit gjatë vazhimit të sotëm të seancës konstituive.

Ndryshimi i mënyrës së votimit në mes të seancës, në mënyrë arbitrare nga kryesuesi dhe pa bazë në Rregulloren e Punës së Kuvendit, përbën shkelje të parimeve procedurale dhe një precedent të rrezikshëm për funksionimin e Kuvendit. Ky veprim jo vetëm që bie ndesh me standardet e një legjislature demokratike, por minon edhe besimin publik në rregullsinë dhe integritetin e proceseve parlamentare.

Çdo përpjekje për t'i ndryshuar rregullat gjatë lojës, veçanërisht kur vjen në funksion të kalkulimeve të brendshme politike, dëmton rëndë autoritetin e Kuvendit.

KDI fton kryesuesin e seancës, Dehari, dhe të gjithë deputetët, në veçanti grupin parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, që t'i

respektojnë standardet procedurale të përcaktuara në Rregullore dhe të veprojnë në përputhje me normat e përgjegjësisë institucionale dhe politike që i kërkon funksioni përfaqësues.

Janë bërë pothuajse tre muaj nga zgjedhjet e 9 shkurtit dhe Kosova ende nuk i ka formuar institucionet e reja. Asnjë parti nuk e fitoi shumicën për të qeverisur e vetme. Lëvizja Vetëvendosje doli e para, me 48 ulëse. Procesi ka ngecur në konstituimin e Kuvendit, më saktësisht emërimin e kryetarit të Kuvendit. Seanca konstituive nisi më 15 prill dhe prej atëherë ka vazhduar 11 herë çdo të dytën ditë pas ndërprerjes. Vetëvendosja po dështon ta emërojë Albulena Haxhiun kryeparlamentare, pasi ajo ka marrë më së shumti 57 vota, 4 më pak se minimumi i nevojshëm për t'u zgjedhur. Së voni, kryesuesi i seancës konstituive që vjen nga Vetëvendosja, ka kërkuar votim të fshehtë, por edhe ky propozim ka dështuar t'i marrë votat e nevojshme. Haxhiu nga disa parti parlamentare konsiderohet "figurë përçarëse", por Vetëvendosja ngul këmbë se ajo është kandidatë meritore dhe nuk do të propozojë kandidat

# VATIKANI, SI KUVENDI I KOSOVËS!

Behxhet Sh.  
SHALA - BAJGORA

Tym i zi për Papën, tym edhe më i zi për Lenkën: Pasi Papa Françesku shkoi atje nga ku nuk ka kthim, Kuvendi i Kardinalëve - Konklava, më 7 maj mbajti votimin e parë për zgjedhjen e Papës. Nëse del tymi i zi nga oxhaku i Vatikanit nënkupton se askush nga kardinalët nuk i ka fituar votat e domosdoshme prandaj duhet votimi i radhës, deri sa të dalë tymi i bardhë kur sekretari i Vatikanit del në ballkonin e katedrales së Shën Pjetrit dhe thotë: "Habermus Papam", "U zgjodh Papa i Ri". Edhe marioneta numër 1 që e ka uzurpuar pozitën e bashkëdrejtuesit të udhëheqjes së mbledhjeve të Kuvendit për zgjedhjen e kryetarit/es dhe kryesisë së Kuvendit për të 12 herë po mundohet, me 100 mijë manipulime kundërkushtuese, të dalë në ballkonin e zyrës së deputetit Albin Kurthi e të thotë: "Habermus Lenka Haxhiu", në shqip: "U zgjodh Lenka Haxhiu", të shoqëruar nga një tym i bardhë. Po nuk po ndodhë se nuk po ndodhë, më parë do të zgjidhet Papa i Vatikanit, se Lenka Haxhiu Papeshë e Kuvendit të Kosovës! Lenka Haxhiu është marionetë numër 2.

Në Vatikan është një rregull se tymi që del nga oxhaku është nga djegia e fletvotimeve të zgjedhjes së dështuar ndërsa në Kuvendin e Kosovës, marioneta numër 1. që i ka uzurpuar dhe turpërisht po i keqpërdorë mundësitë që ia ka siguruar mosha e jo kapaciteti profesional apo intelektual nuk përfill asnjë procedurë jashtë "Rregullave të Kurthit". Nuk ka fletvotime, nuk ka me çka ta ndezë zjarrin nga do të duhej të dalë tymi i bardhë e jo sikur deri më tani që po del tymi Shvartz - katran. Mjerë për ne kush është duke na udhëhequr!

**Letra e Lumit të Xhikës për shokun Albin Kurthi:** Letra e



Kurthit dërguar kryetarit të LDK-së, Lumit të Xhikës me nënshkrim të Albin Pusi ishte si dhurata që ia bënë grekët spartanëve e që njihet si "Kali i Trojës". Dihet mirë se çfarë fati pati Sparta pasi e pranoi këtë "dhuratë", të njëjtin fat do ta kishte edhe LDK-ja po ta pranonte "dhuratën e Kalit të Trojës" nga Kurthi. Letër më dinake, më përçarëse, më nënçmuese, më fyese dhe më të poshtër në aq pak rreshta, moti nuk kam lexuar! Pas kësaj letrë u aktivizuan "akademikët" e LV-së në krye Mehmet Krajën e LV-së, Agim Bahtirin. Ishin mbresëlënëse psherëtimat e Haxhi Qamilit, Dilmal Qishës, Sorre Ximit, Narkomanëve të Prizrenit, Titanit pa Tru etj. që lusnin LDK-në të pranojë "dhuratën greke të Kurthit".

Madje ishte një budalla, i pari në mesin e budallenjve tjerë që kërkonte që Këshilli i Përgjithshëm i LDK-së të mbajë mbledhje të jashtëzakonshme ku do të votohej për letrën e Kurthit. Këtë mbledhje nuk e propozoi anëtari i LDK-së por i LV-së. Deri ku ka shkuar puna! Më duhet të pranoj se psherëtimat e LV-së ishin më me pasion se psherëtimat e të burgosurve që torturoheshin në burgun që ndodhej në "Kanale Grande" në Venedik e që për mrekulli i përshekruante Manzoni në veprën e mrekullueshme: "Il ponti dei sospiri" apo "Ura e psherëtimave". Edhe në radhët e LDK-së kishte mbetje mercenarësh të Vojsa Osmanit që u magjepsën me "dhuratën e Kurthit". Pastaj, e lexova

përgjigjen e Lumit të Xhikës drejtuar Shkëlqesisë së Tij, Diktatorit në detyrë, Albin Kurthit. Moti nuk kam lexuar letër më të strukturuar që e lë lakuriq Kurthin duke e zhveshur nga përrallat e tij për bllokim të opozitës, në njëherë anë sikur edhe një refuzim gjentil për opozitën për krijimin e qeverisë nga opozita. Në gjendjen që jemi, opozitës në asnjë mënyrë nuk i duhet qeveria e pakicës sepse asgjë nuk fiton, as Kosova e as opozita. Madje, në aspektin e përfitimit strategjik pikërisht opozita do të duhej të ishte jetësisht e interesuar që Kurthi ta formojë qeverinë e pakicës me 61 - 62 deputetë. Taktikisht Kurthi do të fitonte në afatin disa muajsh duke blerë kohë për ta shpëtuar qeverinë dhe ministrat super të korruptuar. Në planin afatgjatë do ta thyente qafën, pa mundësi "shërimit", politik dhe kombëtar! Kurthi do të detyrohej të marrë vendime të vështira dhe të dhimbshme me Emily Bronte Rexhepin, të damkosurin Damka, me faraonin Krasniq dhe Komandant Nenadin nga Zona Operative e Luvaxhës sikur edhe me komisarin politik jugosllav Jeton Qurroi. Që, të gjithë së bashku nuk i kanë as 9000 vota. Letra e Lumit të Xhikës është impulsive, 100 mijë herë më e sofistikuar se ajo e Kurthit. Letra e Kurthit dëshmon qartë se Dezhona Mihalidis nuk ishte në ditë më të mira kur shkroi ato letra.

**"Zagarët" virtual:** Nëse dikush del jashtë "Rregullave të Kurthit" pashmangshëm do të përballet me përndjekjen e cyberzagarëve që nuk lënë zorrë pa e gërryer, personale dhe familjare në mbrojtje të Liderit Suprem, Diktatorit Kurthi 1. Lirim Mehmetaj është një gazetar që nuk bënë asgjë tjetër përveç se e kryen punën ashtu si e kërkon morali njerëzor dhe profesional. Dhe pamëshirshëm sulmohet nga "lehësit virtual". Pushkatohet

publikisht që të frikësohet dhe pamundësohet puna e tij që themel, ndërtim, mbindërtim dhe kulm e ka shtyllën kurriore profesionale ashtu siç ia caktojnë përrallat dhe anatomia. I njëjtë është edhe rasti i Shenoll Muharremit. Aktualisht, kjo dyshe e pakorruptuar profesionalisht, mendërisht dhe materialisht është bërthama e masës kritike të veprimtimit opozitar. As i njoh e as nuk i kam takuar por krejtësisht i përkrah, cep më cep. Më parë Kimete Berishën, sajbërzagarët e patën pagëzuar Qimete Berisha. Tash, po të njëjtit e kanë ripagëzuar përsëri Kimete Berisha. A thua pse?

**Zgjedhjet në Shqipëri:** Arben Hito, mik i familjes sime dhe pronar i hotel "Iliria" në Sarandë, më postoi një intervistë të Bacës Adem Demaçi, shumë vite më parë ku jep vlerësime për Sali Berishën dhe Edi Ramën. Po ta dëgjoni këtë intervistë nga zhvillimet e mëpastajme, parashikimet e Bacës Adem janë aq të sakta sa që Nostradamusi dhe Baba Vanga do të dukeshin qesharakë dhe amatorë në parashikimet e tyre. Largpamës ishte Baca, po kujt t'ia hapë sytë?!

Besoj se Rama do të jetë te 50 përqindëshi i votave, nuk ka alternativë më të mirë për Shqipërinë. Shqipëria ndryshoi për të mirë në kohën e Edi Ramës. Nuk jam i majtë, përcaktimi im politik është çështja kombëtare që nënkupton nacionalizëm pozitiv. Këtë nuk e ka siguruar Sali Berisha. Është në konflikt me kohën, i ka ngecur dhe ngelur ora biologjike dhe politike. As La Civita, me 6 milionë dollarë nuk i ndihmon. Shpresoj dhe uroj që partitë e reja të sigurojnë hapësirë për veprim. Ata që po deklarohen për një Shqipëri Madhështore e kanë të qartë se janë e kundërta e madhështisë, vetëm mund ta turpërojnë Shqipërinë. Shqipëria mbi të gjitha!

tjetër pavarësisht prej thirrjeve nga partitë e tjera për një kandidat "më unifikues".

Lidhja Demokratike e Kosovës ka propozuar krijimin e një qeverie tranzitore deri në zgjedhjen e presidentit të ri vitin e ardhshëm.

**PDK-ja: Presidentja mund t'i ndërmarrë hapat e nevojshëm për thirrjen e një takimi me të gjitha partitë parlamentare**

Partia Demokratike e Kosovës një ditë më parë ka mbajtur mbledhjen e rregullt të Kryesisë për të diskutuar rreth zhvillimeve

të fundit politike, për bllokadën institucionale si dhe për propozimet e iniciativat politike aktuale.

PDK-ja ka vlerësuar se vendi ndodhet në një krizë të thellë institucionale si pasojë e sjelljes së papërgjegjshme politike të koalicionit që ka dalë i pari në zgjedhje, por i cili, në mungesë të shumicës parlamentare, po vazhdon ta mbajë peng Kosovën. "Në këtë situatë çdo iniciativë që synon zgjidhjen e bllokadës meriton të dëgjohet dhe diskutohet. Për këtë arsye që nga përfundimi i zgjedhjeve të 9 shkurtit Partia Demokratike e Kosovës ka zhvilluar takime me të gjitha partitë politike

parlamentare - përfshirë edhe Lëvizjen Vetëvendosje, ndonëse e konsiderojmë atë përgjegjëse kryesore për krizën aktuale. Ky angazhim është shprehje e bindjes sonë se dialogu dhe bashkëpunimi janë rruga e vetme për të dalë nga krizat politike dhe për ta rikthyer normalitetin institucional. Andaj, sikur në të kaluarën, as sot dhe as në të ardhmen ne nuk do të shmangemi nga çfarëdo takimi në interes të qytetarëve. Në këtë frymë konsiderojmë se presidentja e Republikës, si institucion mbipartiak dhe me mandat legjitim, mund t'i ndërmarrë hapat e nevojshëm për thirrjen e një takimi me të

gjitha subjektet politike parlamentare. Një tryezë gjithëpërfshirëse mund të jetë hapi i duhur për gjetjen e rrugëdaljes nga kriza institucionale", është theksuar në komunikatën e PDK-së.

PDK-ja ka theksuar se angazhohet dhe është e bindur se zgjidhja më e mirë për vendin është formimi i një qeverie të re, e përbërë nga partitë që në mandatin e kaluar kanë qenë në opozitë. "Një qeveri që do ta ndalte degradimin institucional, do ta nxirrte Kosovën nga izolimi ndërkombëtar dhe do të zbatonte politika zhvillimore për të gjithë qytetarët, pa dallim. Me një listë të dakorduar të prioriteteve

shtetërore, të cilat do ta rikthenin Kosovën në rrugën e duhur të zhvillimit dhe të integritimit euroatlantik. Njëkohësisht, PDK i bën thirrje koalicionit LV - GUXO - Alternativa që të mos abuzojë edhe më tej drejtën kushtetuese për propozimin e kandidatit për kryetar të Kuvendit, por ta pranojë realitetin politik dhe të reflektojë për të mos e mbajtur peng edhe më tutje shtetin për interesa të ngushta partiake. Kosova ka nevojë për institucione funksionale sa më parë. PDK mbetet e angazhuar për ta dhënë kontributin në një proces demokratik dhe kushtetues që çon drejt zgjidhjes", thuhet në komunikatën e PDK-së.

## Universitetet, mes humanizmit, mendimit kritik dhe zhvillimit teknologjik

PRISHTINË, 8 MAJ - Në Konferencën "Roli i universiteteve në zhvillimin socio-ekonomik rajonal të balancuar", rektori Arben Hajrullahu tha se institucionet e arsimit të lartë duhet të mëtojnë ta ruajnë njerëzoren e humanizmin dhe të mos u nënshtrihen vetëm dinamikave të pakontrolluara që mund të shpien në zhvillim afatshkurtër, po jo domosdoshmërisht të qëndrueshëm. Në hapje të konferencës së organizuar nga Ministria e

Zhvillimit Rajonal dhe Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA), që ka partnerë strategjikë Universitetin e Prishtinës dhe Universitetin Gazi të Turqisë, rektori Hajrullahu tregoi se një ditë më parë mes këtyre dy universiteteve më të rëndësishme të Kosovës e Turqisë është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi. Për rektorin Hajrullahu, edhe më parë, po edhe tash, universitetet janë qendra ku trajnohet dhe zhvillohet të menduarit dhe, si rezultat i këtij

reflektimi njerëzor, ndodhin të gjitha zhvillimet teknologjike mes tyre, edhe inteligenca artificiale, pas së cilës asgjë nuk është njëjtë as për universitetet. Përveç rektorit Hajrullahu, të pranishmëve në konferencë me fjalët e tyre iu drejtuan edhe rektori i Universitetit Gazi, Ugur Unal, ambasadori i Turqisë në Kosovë, Sabri Tunç Anglı, ministri në detyrë i Zhvillimit Rajonal, Fikrim Damka dhe kryeministri në detyrë, Albin Kurti. Konferenca vazhdoi me panele diskutuese, në të cilat u trajtua



ndikimi i universiteteve në inovacion, modelet e bashkëpunimit ndërmjet univer-

siteteve, ministrive e komunave dhe bashkëpunimi kulturor e historik për zhvillim rajonal.

## KADETËT E FSK-së, PJESË E GARËS NDËRKOMBËTARE NË WEST POINT TË AMERIKËS

**EPOKA E RE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 8 MAJ - Kadetët e Qendrës për Studime Universitare morën pjesë për herë të parë në garën prestigjioze ndërkombëtare 'Sandhurst Military Skills Competition' në West Point, ShBA. Ky ishte një moment i veçantë për t'i treguar aftësitë e tyre ushtarake, për të përballuar sfida të vërteta dhe për të punuar si një ekip i bashkuar. "Gjatë kësaj eksperience të jashtëzakonshme kadetët tanë u përballën me skenarë të ndryshëm që kërkonin vendosmëri, shkathhtësi dhe vendime të shpejta. Ata patën

mundësinë të mësojnë nga kolegët e tyre ndërkombëtarë dhe të krijojnë lidhje të reja me pjesëmarrës nga e gjithë bota. 'Sandhurst' është shumë më tepër se një garë - është një platformë për bashkëpunim, për ndarjen e vlerave dhe për forcimin e miqësive mes akademive ushtarake. Pjesëmarrja në këtë aktivitet është një hap i madh përpara dhe një motivim i fortë për sfidat e ardhshme", ka njoftuar Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK). Po ashtu, në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) është realizuar me sukses Kursin Bazë për Snajper. Ky kurs kishte për qëllim të përgatisë



snajperë profesionistë në përdorimin e armëve precize dhe zhvillimin e aftësive në

qitje të largët, vëzhgim taktik, identifikim objektivash dhe mbledhje informacioneve në

zona me rrezikshmëri të lartë. Njëkohësisht, kursi ka përfshirë edhe trajnimin e ndihmës qitësit dhe zhvillimin e aftësive të bashkëpunimit dhe komunikimit brenda ekipit të snajperëve në zbatim të misioneve në operacione rurale dhe urbane. Përfundimi me sukses i këtij kursi kontribuon drejtpërdrejt në rritjen e kapaciteteve operacionale të FSK-së, forcimin e njësive të specializuara dhe rritje numrin e snajperistëve profesionistë të cilët janë të gatshëm për t'i përmbushur me profesionalizëm detyrat dhe misionet në operacione komplekse dhe sfiduese.

## "PRISHTINA PARKING", GJYKATA RRËZON GJOBAT DHE BLOKIMET E VETURAVE

PRISHTINË, 8 MAJ - Me një aktgjykim të formës së prerë, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës ka vendosur t'i shfuqizojë disa dispozita të Rregullores për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve të komunës së Prishtinës, duke konstatuar se ato janë në kundërshtim me Kushtetutën, me ligjet në fuqi dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Aktgjykimi i lëshuar në prill të këtij viti erdhi pas padisë së parashtruar nga organizata joqeveritare "Qendra për Raste Gjyqësore" ndaj ndërmarrjes



publike "Prishtina Parking". Dispozitat e kontestuar përfshijnë, ndër të tjera, mundësinë e bllokimit të veturës pas 10 minutave nga momenti i parkimit, vendosjen e tarifave vetëm përmes telefonit, si dhe penalizimet në të ashtuquajturat "vendparkime ilegale". Sipas Gjykatës, këto

dispozita shkelin parimet e proporcionalitetit, mosdiskriminimit, sigurisë juridike dhe të drejtës për pronë, privatësi dhe lëvizje të lirë, të garantuara me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në vendim, Gjykata Supreme ka theksuar se "Prishtina Parking", si ndërmarrje publike komunale, ka vepruar përtej mandatit të saj ligjor dhe statutor, duke ndërmarrë veprime që janë kompetencë ekskluzive e organeve të rendit publik dhe autoriteteve inspektuese. Këto veprime

përfshijnë bllokimin, gjobitjen dhe bartjen e automjeteve pa ndonjë vendim ligjor të një organi kompetent, siç janë Policia e Kosovës apo inspektorati komunal. "Asnjë ndërmarrje publike nuk ka të drejtë ta kufizojë lirinë e lëvizjes ose të ndërhyjë në pronën private të qytetarëve në mungesë të një baze ligjore të qartë dhe të një procedure të rregullt administrative", thuhet në aktgjykim. Pas këtij vendimi të formës së prerë, ndërmarrja "Prishtina Parking" nuk ka më të drejtë ligjore të bllokojë vetura, të

vendosë gjoba apo ta urdhërojë bartjen e automjeteve. Të gjitha veprimet ndëshkuese të ndërmarrja në të kaluarën në mungesë të një akti administrativ individual dhe të ankimeshëm mund të konsiderohen të paligjshme dhe të hapin rrugë për kompensime ligjore. Komuna e Prishtinës obligohet ta rishqyrtojë rregulloren ekzistuese, t'i ndalojë veprimet arbitrare dhe të sigurojë zbatim të standardeve kushtetuese dhe ndërkombëtare, për t'i mbrojtur të drejtat dhe liritë e qytetarëve.

## Kurti viziton drejtorin e QKUK-së Osman Hajdarin, dënon sulmin ndaj tij

PRIZREN, 8 MAJ - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, bashkë me zëvendëskryeministren e tretë në detyrë për çështje të pakicave dhe të drejtat e njeriut, Emilija Rexhepi dhe deputetë të Kuvendit, të enjten bëri homazhe në 25-vjetorin e vrasjes së Ekrem Rexhës, i njohur si komandant "Drini", në Landovicë të komunës së Prizrenit.

Kryeministri Kurti tha se Ekrem Rexha, "komandant 'Drini', ka qenë një veprimtar intelektual, një luftëtar i paepur, i cili me pushkë në dorë dhe me strategji në mendje u përball me armikun e okupatorin serb dhe sot shënojmë 25-vjetorin e vrasjes së tij". Pas homazheve te varri i tij, kryeministri Kurti shprehu mirënjohjen e thellë për

familjen e komandant "Drinit", që e dha një bir kaq të vlefshëm për kombin shqiptar. "Lavdi komandant 'Drinit' dhe gjithë dëshmorëve e martirëve të kombit!" u shpreh kryeministri Kurti. Pas homazheve te varri i komandant "Drinit", kryeministri Kurti do të bëjë homazhe edhe te memoriali në lagjen Bazhdarhane.



# PSE S'KA ZHURMË TË PUNIMEVE NË SHESHIN E PRISHTINËS, POR SHERR MES INSTITUCIONEVE?

Punimet që parashiheshin ta transformonin sheshin "Xhorxh Bush", në kryeqytetin e Kosovës, që dy muaj janë përcjellë me më shumë polemika sesa punime. Ku qëndron problemi dhe si mund të zgjidhet ai?



**PRISHTINË, 8 MAJ** - Në letër duket e thjeshtë: Një komunë e planifikon një projekt, i merr të gjitha lejet e nevojshme, e siguron buxhetin e kërkuar, punimet fillojnë dhe, në fund, pritet shiriti i përfundimit. Por, që dy muaj, punimet që parashiheshin ta transformonin sheshin "Xhorxh Bush", në kryeqytetin e Kosovës, janë përcjellë me më shumë polemika sesa punime. Ku qëndron problemi? Në dy fjalë: trashëgimia kulturore. Për projektin mbi 18 milionë eurosh të komunës së Prishtinës punimet nisën më 10 mars, por ato u ndalën vetëm dy ditë më vonë. Pastaj, prapë më 16 prill, edhe një herë tjetër më 29 prill. Tani kjo zonë, ku asfalti është prerë, ka mbetur nën rrethojë.

## Pse po kundërshtohet projekti në sheshin "Xhorxh Bush"?

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve (IKMM), që funksionon në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë

dhe Sportit (MKRS), thotë se projekti është në kundërshtim me Ligjin për Trashëgimi Kulturor. Në këtë zonë ndodhen disa monumente kulturore të asaj që njihet si Qendra Historike e Prishtinës. Sipas Ligjit për Trashëgimi Kulturor, për projekte në këto zona duhet të merret leje prej IKMM-së, leje të cilën Komuna e Prishtinës nuk e gëzon. Drejtori i Drejtorisë së Transformimit të Komunën e Prishtinës, Gëzim Kastrati, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se aplikimin për këtë leje e kanë bërë më 15 mars, dhe se punimet kanë vazhduar në "zonën publike që nuk [ndërhyjnë te] asnjë aset i mbrojtur". "Synimi është që këto objekte ikonike jo vetëm të mos preken, por të theksohen dhe të valorizohen më tej si pjesë përbërëse e një ansambli të ri urban", shpjegon Kastrati. Por, IKMM-ja dhe MKRS-ja nuk pajtohen. Ato thonë se Komuna e Prishtinës ka ndërhyrë tashmë në perimetrin e zonës së

mbrojtur, që ka kufirin bash aty ku më parë ndaheshin dy shiritat e rrugës "Xhorxh Bush". Komuna e Prishtinës i akuzon këto institucione se veprimet e tyre janë më shumë politike sesa profesionale. (Komuna udhëhiqet nga Përparim Rama i Lidhjes Demokratike të Kosovës, ndërsa Ministria nga Hajrulla Çeku i Lëvizjes Vetëvendosje. Në tetor të këtij viti pritet të mbahen zgjedhjet e rregullta lokale në të gjitha komunat e Kosovës). Por, MKRS-ja e kundërshton këtë argumentim. Ajo thotë se do të aprovonte çdo projekt që respekton ligjet dhe standardet profesionale. Si dëshmi për këtë, në një përgjigje për "REL"-in, ajo përmend se ngjashëm, vitin e kaluar, punimet në ndërtesën e ish-shtëpisë së mallrave Gjermia, në Prishtinë, ishin ndaluar për shkak se mungonte leja. "Por, pas aplikimit për leje pranë institucioneve të trashëgimisë kulturore, projekti u miratua", thonë nga MKRS-ja. Megjithatë, për projektin në "Xhorxh Bush", MKRS-ja ka më

shumë skepticizëm. Ministria beson se ky projekt mund të dëmtojë "trashëgiminë kulturore të Prishtinës".

## Si të ruhet trashëgimia kulturore?

Debati se çka rrezikon asetet e trashëgimisë kulturore ka sjellë përplasje të shumta mes kryetarit të Prishtinës, Rama, dhe ministrit në detyrë të Kulturës, Çeku, dhe atij të Financave, Hekuran Murati. Ata kanë paralajmëruar edhe kallëzime penale ndaj njërit-tjetrit, ndërsa Koha.net ka raportuar se Policia e Kosovës tashmë ka nisur hetimet. Por, me gjithë tentimet, Policia s'e ka konfirmuar këtë për REL-in. Megjithatë, për Sali Shoshin, drejtor ekzekutiv i fondacionit Trashëgimia Kulturorë pa Kufij (CHwB Kosovo), institucionet duhet të lënë mënjandë dallimet politike dhe të punojnë bashkë për të ruajtur identitetin e Prishtinës. "Ta zëmë, Grand-i është një prej hoteleve të para moderne që ka mbërritur në

Prishtinë, Radio Prishtina ka qenë mediumi më i rëndësishëm për 30 vjet", thotë Shoshi për "REL"-in.

Ai shton se procesi për të vendosur se çka përbën identitetin e Prishtinës e çka jo do të duhej të bëhej përmes një konsensusi mes qytetarëve, Komunës dhe Ministrisë. E kur një zonë të shpallet si zonë në mbrojtje, ai thotë se duhet të ketë një dosje që tregon se çfarë lloj materialesh mund të përdoren për konservim të asaj zone, në çfarë lartësie mund të ndërtohet, cilat zona kadastrale preken e shumë gjëra të tjera. "Pa këtë dosje, gjithçka mbetet subjekt i interpretimit subjektiv", vlerëson Shoshi. Por, ai thekson se ruajtja e aseteve të trashëgimisë kulturore s'do të thotë se s'mund të ketë zhvillim urban. "Një prej tyre [ndërhyrjeve të mirëpritura] është ecja e lirë në shesh të pangarkuar [me makina]. Por, nëse mund të ecësh, s'do të thotë që mund të ndërtohet një objekt që e pengon pamjen të diçka që ne po themi që tash për tash ka vlerë", përfundon ai.

## Gjykata Kushtetuese e Kosovës bëhet anëtare me të drejta të plota e ACCF-s

Prishtinë, 8 maj - Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës është pranuar anëtare me të drejta të plota në Asociacionin e Gjykatave

Kushtetuese Frankofone (ACCF). Vendimi u mor gjatë Kongresit të 10 të ACCF-së, mbajtur nga 6 deri më 8 maj 2025 në Bukuresht, Rumania. Ky

anëtarësim forcon më tej bashkëpunimin ndërkombëtar të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, e cila tashmë është pjesë e Konferencës

Evropiane të Gjykatave Kushtetuese dhe një nga themelueset e Forumit Ballkanik të gjykatave kushtetuese.



## Ankandi i pestë i letrave me vlerë mbahet më 16 maj 2025, në vlerë 20 milionë euro

PRISHTINË, 8 MAJ - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka njoftuar se më 16 maj 2025 do të mbahet ankandi i pestë për vitin 2025. Në këtë ankand do të emetohen obligacione me maturitet trevjeçar në shumën prej 20 milionë

eurosh. “Investimi në obligacione është investim i sigurt, i garantuar me Ligjin për Borxhin Shtetëror dhe Garancitë Shtetërore, ku interesi i përcaktuar nga tregu ju garantohej për të gjithë kohëzgjatjen (3 vjet) dhe është tërësisht i liruar

nga tatimi”, thuhet në njoftim. Për hollësi rreth pjesëmarrjes në ankande për blerjen e letrave me vlerë, Ministria e Financave njofton se mund të kontaktohet ndonjëra nga bankat komerciale që operon në Republikën e Kosovës.



## RRITEN ÇMIMET E MALLRAVE NË BUJQËSI



PRISHTINË, 8 MAJ - Indeksi i përgjithshëm i çmimeve të mallrave bujqësore shënon rritje të lehtë në tremujorin e parë të këtij viti krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, indeksi i mallrave të përgjithshëm (Input 1 + Input 2) ka rritje për 0,1 për qind, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024. “Në TM1 2025 indeksi i Input 1 ka rënie për 2,5 për qind, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024, kurse Indeksi i Input 2 ka rritje për 3 për qind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024”, thuhet në njoftimin e ASK-së. Produktet që e përbëjnë bazën për Indeksin e Çmimit të Inputeve janë të ndara në dy grupe kryesore: Mallrat dhe shërbimet aktualisht të konsumuara në bujqësi (Input 1) dhe Mallrat dhe

shërbimet që kontribuojnë në investimet në bujqësi (Input 2). “Brenda grupit të mallrave dhe shërbimeve aktualisht të konsumuara në bujqësi, çmimet grumbullohen sipas grupeve në vijim: farëra dhe material mbëlthues, energji; vajra, plehra dhe përmirësues të tokës, produkte për mbrojtjen e bimëve dhe pesticide, shpenzime për veterinar, lëndë për ushqimin e kafshëve, mirëmbajtja e materialeve, mirëmbajtja e ndërtesave, si dhe mallra dhe shërbime tjera”, thuhet në njoftim. Sa iu përket mallrave dhe shërbimeve që kontribuojnë në investimet bujqësore, sipas ASK-së, çmimet grumbullohen për materiale (makineri dhe pajisje të tjera), ndërtesat dhe të tjera (ndërtesat jorezidente të fermës, punët e tjera përveç përmirësimit të tokës).

## RRITEN TË HYRAT E QEVERISË NË VITIN 2024 KRAHASUAR ME VITIN 2023

**EPOKA  
ERE**

**Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 8 MAJ - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar llogaritë qeveritare për vitin 2024. Ky publikim paraqet pasqyrën e të hyrave dhe shpenzimeve qeveritare brenda kësaj periudhe. Gjithsej të hyrat e qeverisë së përgjithshme në vitin 2024 ishin 3 222.7 milionë euro, ndërsa të hyrat në vitin 2023 ishin 2 860.7 milionë euro. Pjesën më të madhe të të hyrave e përbëjnë tatimet në produkte, të cilat paraqesin 71 % të totalit të të hyrave, tatimet rrjedhëse në të ardhura 15 %, pagesat për prodhimin jashtë tregut (shitjet) 4 %, ndërsa pjesa e mbetur e të hyrave është shpërndarë në kategori të tjera të të hyrave.

Gjithsej shpenzimet e qeverisë së përgjithshme në vitin 2024 ishin 3 189.3 milionë euro, ndërsa shpenzimet në vitin 2023 ishin 2 925.5 milionë euro. Pjesën më të madhe të shpenzimeve e përbëjnë: kompensimi i punëtorëve 25 %, kontributet sociale dhe përfitimet 24 %, formimi i kapitalit bruto 16 %, konsumi i ndërmjetëm 14 %, ndërsa pjesa e mbetur e shpenzimeve është shpërndarë në kategoritë e tjera të shpenzimeve.



## 1.5 milion euro investime të reja infrastrukturore në Rahovec



RAHOVEC, 8 MAJ - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, së bashku me zëvendësministrin e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Hysen Durmishi, nënshkruan një memorandum bashkëpunimi që sjell mbi 1.5 milion euro investime të reja

infrastrukturore për këtë komunë. Përmes këtij bashkëpunimi me MMPHI-në do të bashkëfinancohen dy projekte të rëndësishme: Rregullimi i rrugës Sapniq - Nashpall, në vlerë prej 894 888.00 eurosh; Ndërtimi i rrugës Fortesë - Celinë, në vlerë prej 650

000.00 eurosh. “Falënderoj zëvendësministrin Durmishi për mbështetjen e vazhdueshme dhe për angazhimin konkret për Rahovecin! Këto projekte priten të nisnin së shpejti dhe do ta përmirësojnë ndjeshëm infrastrukturën”, ka thënë Latifi.



# PARAJSAT FISKALE, VENDE KU TË PASURIT PËRFITOJNË MË SHUMË LEHTËSIMA TATIMORE?

Qeveritë europiane po përballen me kufizime buxhetore. Rritja e dobët, tronditjet tregtare dhe plakja e popullsisë vazhdojnë të godasin arkën shtetërore, ndërsa vendet po përpiqen gjithashtu të rrisin shpenzimet e mbrojtjes. Në këtë sfond, vendet europiane po konkurrojnë për të tërhequr dhe mbajtur të pasurit, të etur për investime dhe të ardhura tatimore që mund të sjellin.

## Italia

Italia është një destinacion popullor për emigrantët jo vetëm për kulturën dhe klimën e saj, por edhe për shkak të lehtësirave tatimore. Në pamje të parë, vendi ka taksë relativisht të larta mbi të ardhurat personale dhe të korporatave, megjithëse ka stimuj tatimorë në dispozicion për të huajt.

Një nga më të njohurit është regjimi i tij i taksës së sheshtë, i cili u lejon individëve të pasur të paguajnë një shumë fikse për të gjitha të ardhurat me burim të huaj. Kjo pavarësisht nga shuma e fituar. Tarifa fikse vjetore është rritur së fundmi në 200,000 €, nga 100,000 € që ishte më parë. Avantazhi është i disponueshëm deri në 15 vjet dhe është gjithashtu i hapur vetëm për ata që nuk kanë qenë banorë tatimorë në Itali për të paktën 9 nga 10 vitet e fundit. Duke pasur parasysh koston e taksës së sheshtë, është interesante vetëm për individët me pasuri neto shumë të lartë.

## Zvicra

Zvicra gjithashtu ka një lloj skeme të shumës së plotë (forfait fiscal), megjithëse shteti zviceran pretendoi vitin e kaluar se më pak se 0.1% e taksapaguesve të saj u ngarkuan duke përdorur këtë metodë. Mënyra se si funksionon është se, në vend që të mbledhin tarifa bazuar në të ardhura ose pasuri, disa rajone zvicerane llogarisin një normë zvicerane shpenzimet e një individit. Ndërsa skema e shumës së plotë mund të jetë interesante për super të pasurit, shteti ka vendosur një bazë minimale tatimore.

**Kjo është shifra më e lartë nga dy shifra:** ose shtatë herë më e lartë se qiraja juaj vjetore ose vlera e qirasë së pronës suaj kryesore, ose më e lartë se 429,100 CHF



(rreth 455,000 €) – që nga viti 2024. Këto pragje zbatohen në nivel federal, megjithëse rajone specifike mund ta rrisin shumën minimale.

Ju keni të drejtë për pagesën fiskale të paracaktuar nëse nuk keni shtetësi zvicerane dhe nëse vini të jetoni në vend për herë të parë – ose pas një mungese prej 10 ose më shumë vitesh. Përfituesve gjithashtu u ndalohej të punësohen ose të drejtojnë një biznes në Zvicër. Kjo do të thotë se skema synon të joshë një numër të vogël emigrantësh të pasur që kanë të ardhura pasive.

## Portugalia

Përfitimet tatimore janë bërë një temë polemike në Portugali për shkak të kostonë së lartë të jetesës, e cila është nxitur pjesërisht nga mbërritja e të huajve të pasur. Megjithatë, pas zvogëlimit të përfitimeve në vitin 2023, qeveria portugeze tani ka rikthyer lehtësimet tatimore për emigrantët (Rezidenca Jo-Zakonore 2.0).

Në veçanti, kjo tërheqje një numër të madh pensionistësh, të cilët vendosën të zhvendoseshin në Portugali dhe të mos paguanin taksë mbi të ardhurat mbi të ardhurat e tyre nga pensionet e huaja. Për ata që gjeneronin të

ardhura në Portugali, aktivitete specifike tashmë me një normë të favorshme prej 20%. Përveçse i bezdisi vendasit, sistemi i NHR-së shkaktoi kritika nga shtetet nordike, të cilat po vëzhgonin një eksod të qytetarëve të tyre të moshuar. Finlanda dhe Suedia bënë kërkesa zyrtare për të ndryshuar rregullat e tyre të traktatit të taksës së dyfishtë me Portugalinë.

Kjo do t'u lejonte atyre të vendosnin taksë mbi pensionet e emigrantëve të tyre migrues. Në përgjigje të presionit, Portugalia tani ka ndryshuar lehtësimet e saj tatimore për t'u përqendruar te njerëzit me arsim që mund të kontribuojnë vërtet në ekonominë portugeze.

Sipas rregullave të NHR 2.0, profesionistët e kualifikuar mund të sigurojnë një normë tatimi mbi të ardhurat personale prej 20% për 10 vjet rresht, së bashku me ulje të taksave mbi burime të caktuara të të ardhurave të huaja. Pensionet e huaja përjashtohen nga ky përjashtim, që do të thotë se ato janë plotësisht të tatueshme sipas normave standarde.

## Kompani fiktive (guace)

Një mënyrë tjetër që individët e

pasur mund të gëzojnë norma të ulëta efektive tatimore është përmes përdorimit të kompanive fiktive, sipas Observatorit Tatimor të BE-së. Organi vëren se këto firma janë “në një zonë gri midis shmangies dhe evazionit” në kuptimin që ato janë të dizajnuara për të shmangur tatimin mbi të ardhurat.

Individët që strehojnë asetet në këtë mënyrë vendosin ta vendosin pasurinë e tyre në emër të një kompanie që kontrollojnë, në vend që ta klasifikojnë atë si të ardhura personale. Një tipar kryesor i një kompanie fiktive është se ajo nuk ka operacione aktive biznesi.

Tërheqjet nga kompania tashmë me norma normale, megjithëse tatimpaguesi mund ta fshehë tepërcën në firmën mbajtëse. Ngritja e një strukture të tillë është veçanërisht fitimprurëse në vendet ku norma e taksës së korporatave është e ulët.

Vendet interesante janë, pra, Irlanda (12.5%), Hungaria (9%), Bullgaria (10%) dhe Qiproja (12.5%). Ndërsa OECD ka punuar me shtetet anëtare për të futur një normë minimale globale të taksës së korporatave prej 15%, kjo vlen vetëm për firmat që fitojnë më shumë se 750 milionë euro. Më shumë se 140 vende e kanë nënshkruar marrëveshjen,


por zbatimi është ende një punë në zhvillim e sipër.

Një parajsë tatimore për një person nuk është parajsë për të gjithë. Planifikimi tatimor nuk mund të sillet thjesht rreth një ose dy llojeve të normave, por përkundrazi duhet të merren në konsideratë një mori faktorësh, thonë ekspertët. Tarifat që duhen mbajtur mend përfshijnë taksat mbi të ardhurat personale dhe të korporatave, fitimet kapitale, trashëgiminë dhe pasurinë – si dhe tarifën e sigurimeve shoqërore.

Përveç vendeve të listuara më sipër, vende të tilla si Malta dhe Monako mund të konsiderohen të gjitha me avantazhe fiskale, por gjithçka varet nga natyra e të ardhurave të dikujt. Në disa raste, kjo do të thotë që edhe zonat me taksë të larta si Belgjika mund të quhen parajsë. Ndërsa OECD vazhdon përpjekjet për të rritur taksën e korporatave, ende nuk është parë nëse kjo do të inkurajojë bisedat rreth normave të tjera dhe do të zvogëlojë lehtësimet tatimore.

Kombësitë e joshjes së të huajve të pasur janë një pyetje që vazhdon të dominojë debatet politike, me shtytjen dhe tërheqjen që do të vazhdojë.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Myers, 'MVP' i finales së dytë

Qendra amerikane, Michael Myers, është shpallur "MVP" i ndeshjes së dytë finale të play-offit në mes të Trepçës e Bashkimit në Superligën e

Kosovës në basketboll. Trepça e mposhti Bashkimin në Mitrovicë për ta barazuar serinë finale në 1:1, ndërsa më i merituari për fitoren e

kampionës në fuqi ishte Myers. Amerikani Myers ishte i pandalshëm në trapez dhe ndeshjen e mbylli me 22 pikë, 9 kërcime e 4 asistime. Myers është

përzgjedhur "MVP" i këtij takimi me votat e publikut, ndërsa në garë për këtë çmim ishin edhe Tekele Cotton e Drilon Hajrizi të Trepçës, si dhe Lejson Zeqiri e

Dirk Williams të Bashkimit. "MVP" i finales së parë, të cilën e fitoi Bashkimi të dielën e shkuar, ishte zgjedhur fundori amerikan Wendell Green.

# FFK-ja shpërndan Licencat C për trajnere



**PRISHTINË, 8 MAJ** - Federata e Futbollit e Kosovës për herë të parë ka organizuar një kurs të veçantë për trajneret e kategorisë së femrave, në përputhje me standardet e FIFA-s për Licencën C. Pas një periudhe disamujore me ligjërata dhe trajnime, sot është finalizuar puna me shpërndarjen e licencave për 30 vajza të reja, të cilat në të ardhmen synojnë ta ushtrorjnë profesionin e trajnerëve të futbollit. Licencat u ndanë nga presidenti i FFK-së, Agim Ademi, u. d. sekretari i përgjithshëm i FFK-së, Markus Weidner, si dhe shefja e Departamentit të Edukimit, Sanije Krasniqi. Presidenti Ademi i përgëzoi vajzat për rrugëtimin që kanë zgjedhur për t'u bërë trajnere futbollit, si dhe u dëshiroi suksese në të ardhmen. Ai, po ashtu, u kërkoi atyre të përkushtohen

edhe më shumë në avancimin e futbollit të femrave. "Uroj që të gjitha mësimet që i keni marrë gjatë këtij kursi t'i shohim me rezultat tuaj në fushë. Mos u mjaftoni me Licencën C, por përkushtohuni për kualifikime të tjera, që në mënyrë profesionale dhe bashkërisht ta ngrehim futbollin e femrave. Ne kemi parë se ka shumë talente dhe me projektet tona do të mundohemi t'ua lehtësojmë rrugën drejt qëllimeve dhe sukseseve tuaja", ka thënë Ademi. Olsa Musliu, një nga pjesëmarrëset në këtë kurs, u shpreh e lumtur që është pajisur me këtë licencë, derisa pohoi se ky do të jetë motiv shtesë për t'u përkushtuar edhe më shumë në futbollin e Kosovës. Agnesa Gashi, tashmë e kualifikuar me Licencën C, theksoi se nuk ka

qenë shumë e lehtë deri te kualifikimi në këtë kategori për shkak të trajnimeve dhe ligjëratave të shumta, por se dëshira për futbollin ka bërë që t'i përvishet punës pavarësisht prej sfidave. Edhe shefja e Departamentit të Edukimit në FFK, Sanije Krasniqi, u shpreh e lumtur për punën që është bërë në përgatitjen profesionale dhe zhvillimin e vajzave të reja, të cilat në të ardhmen pritet të punojnë si trajnere në futbollin e femrave në Kosovë. Ajo theksoi se këto kurse janë të nevojshme sepse ndikojnë drejtpërdrejt në njohuri shtesë për vajzat. Ky kurs, bashkë me shumë projekte të tjera që FFK ka në plan-program për zhvillimin e futbollit të femrave, pritet të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë dhe pjesëmarrjes së vajzave në këtë sport.

### SHKURT

#### Sparta kërkon 2.5 milionë euro për Rrahmanin

Sulmuesi i Përfaqësueses së Kosovës, Albion Rrahmani, pritet të largohet nga Sparta e Pragës pas vetëm një sezoni. Mediumet në Çeki kanë raportuar se Rrahmani nuk bën pjesë në planet e Spartës për të ardhmen dhe do të shitet gjatë kësaj vere. Në fakt, thuhet se Sparta tashmë e ka nxjerrë në shitje Rrahmanin dhe ka caktuar çmimin për kartonin e tij, i cili është përgjysmë më lirë sesa që e kishte blerë. Për ta lënë të lirë Rrahmanin në verë, Sparta po kërkon të paktën 2.5 milionë euro, kurse e bleu verën e shkuar nga Rapidi i Bukureshtit për 5 milionë euro. 24-vjeçari duket se nuk është përshtatur te Sparta, ekip që priste shumë prej tij pasi këtë sezon ka vetëm 9 gola e 3 asistime në të gjitha garat.

#### Bilalli në gjendje të mirë, i kthehet vetëdija

Mesfushori i Gjilanit, Oltion Bilalli, është zgjuar të enjten me vetëdije dhe gjendje dukshëm më të përmirësuar shëndetësore. Bilalli ka pësuar një lëndim serioz gjatë ndeshjes ndërmjet Gjilanit dhe Malishevës të martën, pas një dueli në ajër me portierin Ilir Avdyli. Ai është detyruar të largohet nga fusha me autoambulancë, duke u dërguar menjëherë në spitalin e qytetit të Gjilanit për trajtim të mëtutjeshëm dhe pastaj në QKUK në Prishtinë. Ai pësoi një gjakderdhje të brendshme në kokë dhe këto dy ditë kanë qenë të vështira për të, edhe pse është raportuar se ai është jashtë rrezikut për jetën. Megjithatë, gjatë ditës së enjte ka ardhur një lajm pozitiv, ku lojtarit të ri i është kthyer vetëdija.

#### Mitrovica dhe Dukagjini fitojnë ndeshjet e para gjysmëfinale

Janë zhvilluar këtë mesjavë ndeshjet e para gjysmëfinale në kuadër të Kupës së Kosovës për femra, ku Mitrovica dhe Dukagjini kanë marrë fitore të rëndësishme, duke hedhur hap të madh drejt finales së madhe. Në sfidën e zhvilluar në Malishevë, skuadra e Mitrovicës e mposhti Malishevën, me rezultat 2:1. Blerita Shala kaloi mitrovicaset në epërsi në minutën e 19. Shifrat i barazoi Fortesa Berisha në minutën e 39. Megjithatë, për fitoren e Mitrovicës u përkujdes Erjona Emërllahu, e cila realizoi gol në minutën e 61-të, duke i dhënë skuadrës së saj një avantazh të vlefshëm për ndeshjen e kthimit. Ndërkohë, në takimin tjetër të gjysmëfinale, Dukagjini tregoi forcën në shtëpi, duke e mposhtur Prishtinën me rezultat 2:0. Pavarësisht një ndeshjeje të luftuar, vendaset arritën të shënojnë dy gola në periudhën e fundit të takimit përmes Albina Hotit në minutën e 78 dhe Anjeza Berishës në minutat shtesë (90+). Ndeshjet e kthimit të këtyre gjysmëfinaleve do të zhvillohen më 14 maj.


## Gjithçka gati për Turneun Ndërkombëtar të Boksit 'Lah Nimani'

Prishtinë, 8 maj - Federata e Boksit e Kosovës (FBoxK) do ta organizojë Turneun e 17 Ndërkombëtar "Lah Nimani", i cili do të mbahet më 17 dhe 18 maj në Pallatin e Rinisë dhe të Sporteve në Prishtinë. FBoxK-ja i ka bërë

të gjitha përgatitjet për organizimin sa më të mirë të këtij turneu, i cili nga viti në vit po bëhet edhe më masiv dhe cilësor. Turneu është në kalendarin e garave evropiane dhe botërore dhe vlerësohet një prej ngjarjeve

më të mëdha të sportit në Kosovë. Pjesëmarrës në këtë turne do të jenë boksierë nga Kosova, Bullgaria, Kroacia, Sllovakia, Shqipëria, Mali i Zi dhe nga Maqedonia e Veriut. Selektori Faton Xhakli e ka

bërë përzgjedhjen e boksierëve që do ta përfaqësojnë Kosovën. Gjysmëfinalët do të zhvillohen më 17 maj, me fillim nga ora 16:00, ndërsa finalët të nesërmen, më 18 maj, me fillim nga ora 12:00.



## Tifozët e Al Nassrit kundër Ronaldos, kërkojnë largimin e tij

RIYADH, 8 MAJ - Tifozët e Al Nassrit janë kthyer plotësisht kundër Cristiano Ronaldos pasi kanë vënë re atë që ai bëri gjatë humbjes shkatërruese ndaj Al Ittihadit. Al Nassri rifilloi sezonin në Superligën e Arabisë Saudite pas eliminimit në Ligën e Kampionëve të AFC ndaj Kawasakit. Ronaldo humbi një shans të madh në minutën e 95-të duke e

eliminuar ekipin nga gara. Ëndrra e tyre për në ligë tani ka mbaruar, pas humbjes së tyre shkatërruese 3-2 ndaj rivalëve të Al Ittihadit. Housseem Aouar shënoi një gol fitoreje në minutën e fundit duke e dënuar Al Nassrin me humbje të dytë radhazi në të gjitha garat. Ronaldo, i cili nuk arriti të shënonte, tregoi frustrimin e tij kur Aouar

shënoi në minutën e 94-t. Ai mund të shihet duke ngritur duart lart me neveri, ndërsa kritikohet nga tifozët e Al Nassrit në rrjetet sociale. Ish-ylli i Manchester Unitedit u cilësua "qesharak" pasi disa tifozë duan që atij t'i hiqet shiriti i kapitenit. "Shikoni si po sillet kapiteni ynë qaraman. CR7 është gjëja më e keqe që i ka ndodhur ndonjëherë Al

Nassrit. Ultrasit po e kërkojnë këtë. Largojeni Cristiano Ronaldon nga klubi im. TANI", shkroi një tifoz në platformën X. "Po i lëviz duart sikur të ketë bërë diçka këtë sezon", "Filloni me shiritin e kapitenit... ai nuk e meriton shiritin e kapitenit" dhe "Ai e mashtroi Al Nassrin për tri vjet të plota për 900 milionë dollarë", ishin disa nga komentet e tjera të tifozëve.



Ndryshe, Al Nassri renditet në vendin e katërt në ligë dhe është 11 pikë larg liderëve të Al Ittihadit.

## Zanetti: Finalja me PSG-në është 50 me 50, Inzaghi lider absolut, Lautaro meriton 'Topin e Artë'

MILANO, 8 MAJ - Legjendë dhe aktualisht nënkryetar i Interit, Javier Zanetti, ëndërron një kalim simbolik të stafetës: nga kapiteni i dikurshëm te kapiteni aktual, nga një argjentinas te një tjetër, nga duart e tij tek ato të Lautaro Martinezit, me trofeun e Ligës së Kampionëve në mes. Pas fitores së vështirë ndaj Barcelonës në gjysmëfinale, Zanetti foli për "Radio La Red", duke komentuar finalen e 31 majit kundër Paris Saint-Germainit në Muni. "Jam krenar për paraqitjen e Interit", u shpreh Zanetti. "Ndaj Barcelonës, si në vajtje ashtu edhe në kthim, skuadra tregoi përkushtim dhe kaloi me sukses çaste të vështira. U përballën dy ekipe me stile të qarta dhe mënyra të ndryshme loje. Finalja ndaj PSG-së? Është një ndeshje 50 me 50. Ata,




gjithashtu, e merituan finalen. Është një përballje teke dhe duhet ta luajmë me vendosmëri, duke shpresuar ta mbajmë nivelin që treguam në gjysmëfinale". Zanetti nuk

kurseu lavdërimet për trajnerin Simone Inzaghi, arkitektin e këtij suksesi: "Ai është lideri absolut i kësaj skuadre. Është me ne prej katër vjetësh dhe i ka bërë të gjithë shumë konkurrues. Me të kemi arritur dy finale të Ligës së Kampionëve brenda tre vjetësh". Në qendër të lavdërimeve ishte edhe kapiteni Lautaro Martinez: "Shpresoja që një ditë do të bëhej lojtari që është sot. Kundër Barcelonës dhe gjithçka derisa u zëvendësua. Ai është thelbësor si për Interin ashtu edhe për Kombëtaren. Jep gjithmonë maksimumin. Nuk ka asnjë dyshim që ka potencialin për ta fituar 'Topin e Artë'. Këtu ndihet i lumtur, i vlerësuar dhe i rëndësishëm. Ka një ndjenjë të fortë përkatësie dhe kur ndihesh mirë aty ku je, kjo të ndihmon të shkelqesh".

## New Yorku surprizon Bostonin, Oklahoma shkatërron kampionët

NJU-JORK, 8 MAJ - "Play-off"-et e NBA-s vazhdojnë të sjellin emocione dhe surpriza të mëdha. Mbrëmja e fundit solli një fitore dramatike për New York Knicksin ndaj Boston Celticsit, ndërsa Oklahoma City Thunderi dhuroi një paraqitje historike, duke turpëruar Denver Nuggetsin me një diferencë të jashtëzakonshme. Në një ndeshje të tensionuar nga fillimi në fund, New York Knicks arriti një fitore të artë në parketin e "TD Garden", duke mposhtur favoritin e konferencës, Boston Celticsin, me vetëm një pikë diferencë (91-90). Jalen Brunson ishte lideri i padiskutueshëm për Knicksin me 36 pikë, përfshirë edhe koshin vendimtar në sekondat e fundit. Celticsi humbi



një mundësi të artë për ta marrë kontrollin e serisë, pasi Jayson Tatum nuk arriti të shënojë në posedimin final. Kjo ishte një humbje që ngre pikëpyetje mbi menaxhimin e situatave nën presion nga skuadra e Joe Mazzulla. Në Perëndim, Oklahoma City Thunderi dhuroi një nga

performancat më spektakolare të "play-off"-it duke shkatërruar Denver Nuggetsin, me 43 pikë diferencë. Shai Gilgeous-Alexander ishte i pandalshëm me 38 pikë, ndërsa edhe Josh Giddey, Jalen Williams dhe Chet Holmgren kontribuan fuqishëm në një paraqitje kolektive të përsosur. Oklahoma shënoi plot 149 pikë, duke u dhënë një goditje të rëndë kundërshtarëve, të cilët u dukën të dorëzuar dhe të shpërqendruar pas pjesës së parë. Për Denverin, Nikola Jokiqi pati një paraqitje të zbehtë dhe mungesa e reagimit nga pjesa tjetër e skuadrës ishte alarmante. Ky rezultat mund të jetë një kthesë dramatike për vazhdimin e serisë.

### SHKURT

#### Shkëndija shpallet kampione në Maqedoninë e Veriut

Shkëndija e Tetovës është kampione e re e Maqedonisë së Veriut. Skuadra nga Tetova e fitoi kështu titullin e pestë të kampionit në historinë e saj. Ekipi shqiptar e mposhti Rabotniçkin me rezultat 2:1 për ta krijuar një distancë të mjaftueshme ndaj ndjekësve, dy xhiro pa përfunduar sezoni. Për herë të fundit Shkëndija ishte shpallur kampione e Maqedonisë së Veriut në vitin 2021.

#### Enrique: Duam ta shkruajmë historinë e PSG-së

PSG-ja siguroi një biletë për në finalen e Ligës së Kampionëve pas dy fitoreve kundër Arsenalit. Luis Enrique nuk e fshehu gëzimin për këtë arritje të madhe, derisa ka thënë se synojnë ta shkruajnë historinë e PSG-së. "Kjo ishte një ndeshje e çuditshme, ishte një ndeshje ndryshe nga sfida e parë. Arsenalu u përpoq të luante shumë me goditje standarde, ne u mbrojtëm mirë dhe arritëm ta shënonim golin e parë me kundërsulm. Donnarumma? Ashtu si në ndeshjen e parë, edhe këtë herë ishte fantastik. Ekipi ynë është mësuar të sulmojë dhe të mbrojë larg zonës, të kesh një portier si ai është thelbësor. Objektivi ynë është ta shkruajmë historinë e PSG-së, për ta bërë këtë duhet të fitojmë Ligën e Kampionëve", ka thënë Enrique.

#### Napoli në garë për De Bruynen

Napoli është në ethet e festës së titullit kampion. Drejtuesit e klubit po planifikojnë me kujdes të ardhmen dhe kanë nisur të ëndërrojnë një goditje të madhe në merkato: Kevin De Bruyne. Sipas raportimeve nga "Sky Sport", klubi napolitan ka nisur kontakte konkrete për mesfushorin belg të Manchester Cityt, i cili do të jetë lojtar i lirë në fund të sezonit. De Bruyne, i lindur në vitin 1991, ka kaluar një dekadë të artë në Manchester, ku ka regjistruar 418 paraqitje, 108 gola dhe 177 asistime. Megjithatë ka oferta tërheqëse nga Arabia Saudite, belgu pëlqen të qëndrojë në Evropë dhe Napoli është ndër klubet që po e ndjek me më shumë interes. Në garë për të është edhe Liverpooli, kampion i ri i Anglisë.

#### Arteta: Jam shumë krenar për lojtarët

Arsenalit i shkoi shumë pranë finales, por në fund ekipi i Mikel Artetas u dorëzua përballë PSG-së, një përfundim i hidhur, por që nuk i heq aspak krenarinë teknikus spanjoll për këtë rrugëtim fantastik në Ligën e Kampionëve. "Pikësëpari, më duhet t'i bëj komplimente PSG-së për arritjen e finales. Lojtari më i mirë i Parisit në këto dy sfida ishte Donnarumma, bëri diferencën në këtë takim. Mendoj se ishim shumë pranë, shumë më pranë sesa e tregon rezultati. Jam shumë krenar për lojtarët dhe për atë që bënë në këtë takim. Të shoh ekipin tim duke luajtur në këtë formë kundër një prej ekipeve më të mira në Evropë me mbush me krenari. Mbase askush nuk e mendonte që do të vinim deri këtu, por ne i shkuam shumë pranë", ka thënë Arteta.

## Schumacheri, bisedime me makinën debutuese për t'u rikthyer në Formula 1 vitin e ardhshëm

Piloti gjerman Mick Schumacher është pranë rikthimit në Formula 1 pas tri vitesh pushim. Kampion botë në Formula 2 dhe i rritur në akademinë e Ferrarit, karriera e djalit të Michael Schumacherit filloi zyrtarisht në vitin 2021 dhe zgjati dy sezona me Haas. Pa vende të lira për

sezonin 2024, Mick Schumacher vazhdoi si pilot i tretë dhe pilot testimi për Mercedesin, McLarenin dhe Williamsin, ndërsa filloi kapitullin tjetër të karrierës së tij në WEC te Alpine. Por ai asnjëherë nuk i humbi shpresat për një rikthim në Formula 1. Kjo ëndërr mund të

konkretizohet vitin 2026. Vitin tjetër Cadillac do të debutojë në botë, por ende nuk i ka zyrtarizuar pilotët e tij të ardhshëm. Sipas "Bild", Schumacheri u takua me drejtuesit e Cadillac gjatë garës së fundit të zhvilluar në Majemi. Tashmë mbetet për t'u parë nëse gjermani

mund ta përbushë profilin ideal të treguar nga Mario Andretti, këshilltari i makinës amerikane. Për të, çifti ideal i pilotëve do të ishte një amerikan i çiftëzuar me një pilot tjetër me shumë përvojë, pavarësisht kombësisë. Në moshën 26-vjeçare dhe me dy sezona në

karrierë, mbetet për t'u parë nëse Cadillac do të dëshirojë të përqendrohet te djali i Michaelit apo te Sergio Perez, ish-piloti i Red Bullit, me shumë më tepër përvojë se Schumacheri, i cili është treguar vazhdimisht si zgjedhja ideale për ekipin.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada-Government

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRIUR  
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 827 /1  
Dt: 08.05.2025

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 35 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenit 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, neni 81 i Ligjit për Zyrtar Publik Nr. 08/L-197, Udhëzimit Administrativ 14/2014, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2015, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012, Rregullores (Qrk) Nr.19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendës Drejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instrukturëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

**KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS**

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita:	Vend i lirë/ Zëvendësim	Numri i pozitive	Koeficienti i pagës
ShML	Qendra e Kompetencës "Shtjefën Gjeçovi" Prishtinë	Prishtinë	Instruktur për Ndërmarrësi	Vend i lirë	2	6.3

**I. Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për këtë vend pune**

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (vlen për të punësuarit në institucione publike). Kandidatët që nuk janë të punësuar në institucione publike duhet të dërgojnë një vetëdeklarate me shkrim të nënshkruar se nuk kanë masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.

**II. Në momentin e aplikimit, kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:**

- Formulari i aplikimit (merret në Qendrën e Kompetencës për të cilën është shpallur konkursi)
- Rezymeja personale (CV)
- Dokumenti personal (kopje të letërnjoftimit ose pasaportës)
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat të noterizuara)
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHTI
- Çertifikatat e trajnimeve
- Çertifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore
- Dëshminë se nuk është i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje
- Për instruktor me së paku 5 vite përvojë pune në profesion në ndërmarrje, biznese dhe institucione tjera

**III. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor**

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 04/L-032, Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHTI-it: UA Nr. 05/2015, si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

**Kriteret e kualifikimit për Instruktur për Ndërmarrësi**

- Përgatitja/kualifikim Baçelor

**Detyrat dhe Përgjegjësitë për Instruktur:**

- Instruktori është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e teorisë dhe praktikës profesionale.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të praktikës profesionale dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.

- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPAR-së.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

**IV. Vlerësimi i kandidatëve**

- Vlerësimi i njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve bëhet përmes:
- Testit me shkrim, i cili përbënë 50% të vlerësimit të përgjithshëm dhe ka në total 100 pikë.
- Intervista me gojë, pjesë e së cilës është edhe vlerësimi i portfolios, përbënë 50% të vlerësimit të përgjithshëm.
- Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjedhen në pozitat e lartpërmendura.
- Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test me shkrim dhe intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave do të njoftohen me e-mail dhe përmes telefonit.
- Rezultatet përfundimtare të vlerësimit do të dërgohen kandidatëve me e-mail, do të publikohen në tabelën e njoftimeve në shkollë dhe në <https://konkursi.rks-gov.net/>.

**V. Afati dhe mënyra e aplikimit**

- Konkursi mbetet i hapur 30 ditë nga dita e shpalljes nga data 09.05.2025 deri me 07.06.2025.
- Aplikacioni merret dhe dorëzohet në Shkollën përkatëse;
- Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pas afatit, nuk merren në shqyrtim;
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme me rastin e shpalljes së rezultateve përkatëse;
- Anëtarët e komuniteteve jo shumicë dhe personat me afëtesi të kufizuar inkurajohen të aplikojnë në pozitat e shpallura në përputhje me kualifikimet përkatëse.

**Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.**

**Lumë's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Shullat, Rr. Bajram Kelmendi







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

